
RAPORT ALTERNATIV:

ANALIZË E RAPORTEVE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE MBI FUSHATËN ELEKTORALE **2023**

Qershor, 2024





RAPORT ALTERNATIV:

ANALIZË E RAPORTEVE
FINANCIARE TË SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE MBI FUSHATËN
ELEKTORALE **2023**



Qershor, 2024

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri –
Balkan Investigative Reporting Network in Albania (BIRN Albania)
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë
<http://birn.eu.com/>

Autorë: Kristina Voko, Besar Likmeta, Gjergj Erebara

Konsulente: Sabina Babameto, National Democratic Institute (NDI) / Albania

© Balkan Investigative Reporting Network in Albania

Tirana, 2024

Ky raport është hartuar nga BIRN Albania në kuadër të nismës “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – LOTI 2: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe implementuar në partneritet me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Institutin e Studimeve Politike dhe Qëndresën Qytetare. Gjetjet e këtij raporti janë përgjegjësi e vetme e BIRN Albania dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmëri ato të Ambasadës Britanike në Tiranë dhe partnerëve të tjerë.



Përmbajtja:

1.	Konteksti dhe Kuadri Rregullator	7	3.	Gjetjet kryesore	20
	1.1 Zgjedhjet vendore të 14 majit 2023	7		3.1. Të ardhurat e subjekteve zgjedhore	20
	Vëzhguesit ndërkombëtarë	9		3.2. Shpenzimet e subjekteve zgjedhore	24
	Vëzhguesit vendorë	11		Shpenzimet e kandidatëve për kryetar	30
	1.2 Kuadri ligjor	13		Shpenzimet për median dhe rrjetet sociale	31
2.	Qëllimi dhe metodologjia e raportit	17	4.	Diskutime dhe Rekomandime	38
	2.1. Qëllimi i raportit	17		Aneksi I: Deklarimet e kryera gjatë fushatës për zgjedhjet e 14 majit 2023 për secilin zë të ardhurash dhe shpenzimesh sipas subjektit zgjedhor	42
	2.2. Metodologjia	18		Aneksi II: Shpenzimet e deklaruar nga kandidatët në të gjitha bashkitë e vendit gjatë fushatës zgjedhore të 14 majit 2023	49
	Mbledhja e të dhënave	18			
	Analiza e të dhënave	18			
	Mjetet e monitorimit	19			
	Konsiderata etike	19			
	Kufizime	19			
	Raportimi dhe rekomandimet	20			

1. Konteksti dhe Kuadri Rregullator

1.1 Zgjedhjet vendore të 14 majit 2023

Zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të mbajtura më 14 maj 2023 u fituan nga Partia Socialiste në pushtet, e cila arriti të zgjedhë 53 kryetarë bashkie nga 61 bashki në vend.

Koalicioni opozitar “Bashkë Fitojmë” fitoi vetëm 7 bashki dhe 1 bashki (Finiqi) u fitua nga “Partia e Minoritetit Etnik Grek për të Ardhmen”.

Listat e zgjedhësve ftuan 3.65 milionë shqiptarë për të votuar, por vetëm 38.23 për qind e tyre morën pjesë në votim ditën e zgjedhjeve, ose 1,395,645 votues.

Në garë u regjistruan 46 subjekte zgjedhore, 145 kandidatë për kryetarë bashkie dhe 23,646 kandidatë për këshilltarë për të zgjedhur 3,222 anëtarë të këshillave bashkiakë. Shumica e kandidatëve ishin formalë pasi gara kryesore luhej mes Partisë Socialiste, të drejtuar nga Edi Rama, dhe Koalicionit “Bashkë Fitojmë” që drejtohej nga ish-kryeministri Sali Berisha dhe ish-presidenti Ilir Meta.

Fushata u dominua nga liderët kryesorë të partive politike

edhe duke e larguar fokusin nga problematikat lokale të komuniteteve dhe alternativat konkrete për njësitë vendore.

PS-ja u fut në zgjedhje me një avantazh, pasi kishte në kontroll 60 bashki pas zgjedhjeve të 2019-ës ku opozita e atëhershme e drejtuar nga Lulzim Basha bojkotoi garën dhe shumica e kandidatëve ishin kryetarë bashkie në detyrë.

Ndërkohë, opozita u fut e përçarë në këto zgjedhje pas një beteje ligjore mes dy grupimeve në Partinë Demokratike për emrin dhe vulën e partisë duke minimizuar dhe mundësitë e fitores me përballjen e kandidatëve të saj në zona të ndryshme.

Grupimi më i madh kësaj partie, i drejtuar nga Sali Berisha, u detyrua të futet në zgjedhje nën siglën e koalicionit “Bashkë Fitojmë” në aleancë me Partinë e Lirisë të drejtuar nga ish-presidenti Ilir Meta.

Ndërsa grupimi që mbajti emrin zyrtarisht dhe mori fondet e fushatës nuk arriti të garonte me kandidatë për kryetarë bashkie në çdo zonë dhe atje ku kandidoi doli forcë e tretë politike në zgjedhje.

Rezultati u kontestua nga opozita për parregullsi për bashkitë e Elbasanit, Belshit, Kuçovës, Kamzës dhe Rrogozhinës, por vetëm në bashkinë Rrogozhinë Kolegji Zgjedhor vendosi ripërsëritjen e zgjedhjeve për kryetar bashkie. Rezultati shumë i ngushtë i 14 majit në këtë bashki u thellua me fitoren e kandidatit socialist në zgjedhjet e 23 korrikut.

Edhe pse Kodi Zgjedhor kufizon përdorimin e burimeve publike gjatë fushatës, pati dhjetëra denoncime nga partitë opozitare dhe nga organizatat e shoqërisë civile për përdorimin e administratës dhe burimeve të tjera shtetërore nga kandidatët e partisë në pushtet.

Në prag të zgjedhjeve, Kryeministri Edi Rama u premtoi pensionistëve shpërblim në masën 5 mijë lekë¹ edhe pse në ligjin zgjedhor ndalohet dhënia e përfitimeve për kategori të caktuara – ku përfshihet edhe rritja e pensioneve dhe pagave në një periudhë kohore katër muaj para zgjedhjeve.

Rasti u denoncua në KQZ, por Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i interpretoi parashikimet e Kodit Zgjedhor, konkretisht nenin 91, pika 4, si të pazbatueshme për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

Rama bëri dhe premtime të tjera për investime gjatë fushatës dhe “kërcënoi” votuesit se këto investime nuk do të vinin nga qeveria, nëse do të votohej kandidati kundërshtar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bëri disa herë apel dhe miratoi

një udhëzues për institucionet dhe zyrtarët publikë për sjelljen e tyre në fushatën elektorale², në mënyrë që të mos përfshiheshin në veprimtari politike. Megjithatë, një masë e gjerë e ministrave dhe zyrtarëve të tjerë u përfshinë në fushatë për kandidatët socialistë.

Disa drejtues politikë të PS-së dhe kandidatët e tyre për kryebashkiakë shkelën vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aktivitetet e ndaluara me qëllim përdorimin e burimeve publike në prag të fushatës.³

Po ashtu, faqet zyrtare në rrjete sociale të institucioneve publike, si ministri apo drejtoritë arsimore, u përdorën për të shpërndarë fushatën elektorale të Partisë Socialiste ose përdorën hashtage me sloganet politike të fushatës.

Vetëm në pak raste Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) morën masa administrative.

Për përdorimin e burimeve publike u vendosën gjoba për 15 kryetarë bashkie në detyrë që garonin si kandidatë të Partisë

¹ Edi Rama Facebook, Kryeministria - Vendimet e Qeverisë Sot. Marrë nga: <https://www.facebook.com/ediramaal/videos/774363500885395> parë më: 08.02.2024.

² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (12.01.2023). Kujtesë – Mbi veprimtarinë e institucioneve publike katër muaj përpara datës së zgjedhjeve. Marrë nga: <https://kqz.gov.al/2023/01/12/kujtese-mbi-veprimtarine-e-institucioneve-publike-kater-muaj-perpara-dates-se-zgjedhjeve/?fbclid=IwAR06u4bPwfY8HotcmBTZq8EW6lrn-bWeRQka8X3glXwm3-5WwsVtFZtMMn4> parë më: 08.02.2024.

³ Gjoka, B. (06.04.2023) Zyrtarët socialistë injorojnë KQZ-në dhe shfrytëzojnë burimet publike për fushatë. Reporter.al: <https://www.reporter.al/2023/04/06/zyrtaret-socialiste-injorojne-kqz-ne-dhe-shfrytezojne-burimet-publike-per-fushate/> parë më: 08.02.2024.

Socialiste për përdorimin e faqeve zyrtare të bashkive në Facebook për fushatë politike.⁴

Po ashtu, KAS vendosi të gjobiste kryebashkiakun e Tiranës, Erjon Veliaj, dhe ministren e Kulturës, Elva Margariti, për shkelje të Kodit Zgjedhor gjatë një takimi në Teatrin e Operës dhe Baletit përpara zgjedhjeve lokale të 14 majit.⁵

Një masë administrative me gjobë u mor edhe ndaj Drejtoreshës së Kadastrës, Dallëndyshe Bici, me gjobë në vlerën 2,500 lekë, pasi kishte marrë pjesë në dy takime elektorale të kandidatit për kryetar bashkie në Kukës, Safet Gjici, dhe kishte bërë thirrje politike për mbështetjen e kandidatit socialist.⁶

Një prej kryebashkiakëve të PS-së, Safet Gjici i Kukësit, e humbi mandatin vetëm 1 muaj pasi u zgjodh, pasi u përfshi në një skandal seksual dhe më pas u arrestua dhe u dërgua në gjyq për korrupsion. Zgjedhjet e reja në këtë qytet nuk sollën asnjë surprizë pasi PS-ja fitoi sërish me kandidatin e saj Albert Halilaj.

Votuesit që jetojnë jashtë kufijve nuk arritën të votojnë as në këto zgjedhje, edhe pse në Kodin Zgjedhor parashikohej e drejta e votës për këtë kategori. Çështja vijon të jetë e pazgjidhur edhe pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që kërkon nga

parlamenti ndërhyrje në ligj për garantimin e kësaj të drejte.

Vëzhguesit ndërkombëtarë

Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve u krijua nga zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe vëzhgoi fushatën zgjedhore me 24 vëzhgues afatgjatë dhe 300 vëzhgues afatshkurtër në ditën e votimit, në bashkëpunim me delegacionet e Parlamentit Evropian (PE) dhe Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

Misioni vlerësoi përputhshmërinë e proceseve zgjedhore me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas.

Raporti përfundimtar i ODIHR-it, i publikuar në shtator, doli në përfundimin se zgjedhjet ishin të organizuara mirë dhe me pjesëmarrjen e të gjitha partive politike, por ato u shënjuan nga pretendime për keqpordorim të burimeve publike në nivel

⁴ Akte të KQZ, <https://kqz.gov.al/akte-te-kqz-2/>, parë më: 08.02.2024.

⁵ KQZ, Zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 – KAS vendos sanksione administrative, (13.11.2023). Marrë nga: <https://kqz.gov.al/2023/11/13/zgjedhjet-e-dates-14-maj-2023-kas-vendos-sanksione-administrative/>, parë më: 08.02.2024.

⁶ KQZ, Shpërdorimi i burimeve publike – KAS vendos sanksione administrative (08.05.2023). Marrë nga: <https://kqz.gov.al/2023/05/08/shperdorimi-i-burimeve-publike-kas-vendos-sanksione-administrative/>, parë më: 08.02.2024.

qendror dhe vendor, presione mbi punonjësit e administratës publike dhe votuesit, si dhe akuza për blerje vote.⁷

“Rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe zgjedhësit dhe pretendimet për blerje votash ishin shqetësuese”, thuhet në raport.

Raporti kërkon që këto probleme të adresohen.

“Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje të sinqerta për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e kahershëm të blerjes së votave dhe rreziqet që ajo paraqet për integritetin e zgjedhjeve”, thuhet në raport.

Përfaqësitë e Bashkimit European dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në reagimet e tyre pas publikimit të gjetjeve i kërkuan palëve politike në Shqipëri të zbatonin rekomandimet e raportit dhe ngritën shqetësime mbi fenomenin e blerjes së votave dhe përdorimin e aseteve shtetërore në nivel qendror e lokal gjatë zgjedhjeve.⁸

Raporti konstatoi se fushata ishte e lirë, por u anashkaluan çështje me rëndësi për komunitetet vendore, të cilat pothuajse

nuk u përfshinë fare në fushatë.

Po ashtu, vëzhguesit raportuan për probleme në organizimin dhe qëndrueshmërinë e komisioneve të nivelit të ulët (KZAZ-të) në administrimin e zgjedhjeve pasi anëtarët e tyre zëvendësoheshin shpesh nga partitë propozuese.

Problematika e mbulimit në media të fushatës vijon të mbetet, edhe pse kodi ka përcaktuar rregulla të qarta në këtë drejtim.

Sipas vëzhguesve, *“rregullat për mbulimin politik të fushatës në media favorizuan fuqimisht partitë kryesore dhe përdorimi i shpeshtë nga media i përmbajtjeve të përgatitura nga partitë në programet e lajmeve dëmtoi mbulimin gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës”.*

“Shtetet e Bashkuara i kërkojnë qeverisë, partive politike dhe institucioneve shtetërore të zbatojnë rekomandimet e ODIHR-it, të cilat përfshijnë keqpërdorimin e burimeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, akuza për blerje votash nga të gjitha anët, sigurimin e masave mbrojtëse për fshehtësinë e votimit dhe parandalimin e frikësimit të votuesve dhe presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit”, thuhet në deklaratën e SHBA-së.

⁷ OSCE (2023). Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Varshavë. Marrë nga: <https://www.osce.org/sq/odihr/elections/albania/557277> parë më: 08.02.2024.

⁸ Karaj, V. (03.10.2023). BE dhe SHBA kërkojnë zbatimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR për blerjen e votave në zgjedhje. Reporter.al, Marrë nga: <https://www.reporter.al/2023/10/03/be-dhe-shba-kerkojne-zbatimin-e-rekomandimeve-te-osbe-odihr-per-blerjen-e-votave-ne-zgjedhje/> parë më: 08.02.2024..

Bashkimi European nga ana tjetër thotë se raporti ka konfirmuar se zgjedhjet u administruan mirë dhe ishin konkurruese, por njësoj si SHBA-ja, konstaton se zgjedhjet u njollosën nga akuzat për përdorimin e mjeteve shtetërore dhe blerja e votës. “Delegacioni i Bashkimit European inkurajon të gjithë aktorët të punojnë së bashku për të vënë në jetë rekomandimet e reja të Raportit dhe ato që mbeten pezull nga raporti i kaluar si një çështje emergjence”, thuhet në njoftim.

Transparenca në financimin e fushatës mbetet “thembra e Akilit”, që, sipas vëzhguesve, kërkon rregullim të mëtejshëm ligjor.

Raporti konstaton shqetësime për mungesë transparence në financimet e fushatës përpara ditës së zgjedhjeve, pasi garuesve nuk u kërkohet të paraqesin raporte të ndërmjetme për financimin e fushatës ose që të bëjnë të ditur burimin dhe sasinë e fondeve të mbledhura.

“Shpërndarja e vonuar e fondeve publike dhe përcaktimi i vonuar i kufijve të shpenzimeve të fushatës nuk kontribuuan në sigurinë juridike”, konkludon ODIHR.

Misioni vëzhgues rekomandoi një reformë të re zgjedhore që të jetë gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme.

“Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën

zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t’i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë”, rekomandon ODIHR.

Por Komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore, që duhet të kryejë ndryshimet e nevojshme për zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2025, nuk funksionon normalisht duke mbetur “peng” i përplasjeve politike.

Vëzhguesit vendorë

Organizatat e shoqërisë civile, KRIIK, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Qëndresa Qytetare, u shfaqën shumë aktive në monitorimin e procesit zgjedhor duke bërë denoncime të vazhdueshme në KQZ për raste të keqpërdorimit të burimeve publike gjatë fushatës dhe problematika të tjera që shoqëruan këtë proces. Vëzhguesit vendorë ngritën shqetësimin për transparencën dhe kontrollin mbi financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve publike.

KRIIK thotë se e fokusoi monitorimin e saj te transparenca e financimit të fushatës dhe identifikoi disa elementë të shpenzimeve të kryera në funksion të fushatës nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët, konkretisht; shpenzimet në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, reklama politike në disa nga mediat audiovizive dhe reklama politike në disa faqe interneti

online.⁹

“Nga dita e caktimit të ditës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës deri në ditën e zgjedhjeve, janë harxhuar nga 133,561 në 146,910 dollarë amerikanë për 3,332 reklama politike”, gjetën monitoruesit e KRIIK.

Ndërkohë që sipas organizatës, shqetësim mbetet fakti që përveç kandidatëve dhe subjekteve politike ka pasur edhe shpenzime në një masë të konsiderueshme nga palë të treta për këto reklama, kur këto palë nuk kanë detyrim vetëdeklarimi në KQZ.

Kjo organizatë i bën thirrje KQZ-së që të bëjë këtë transparencë financiare në bazë të kuadrit ligjor ekzistues dhe të jetë e vëmendshme në kontrollin e vetëdeklarimeve të subjekteve e kandidatëve.

Nga ana tjetër, KSHH vëren se problemi me administrimin e zgjedhje lidhet me njëanshmërinë partiake të komisionerëve dhe kërkon depolitizim total të komisioneve zgjedhore lokale.

Në raportin përfundimtar të kësaj organizate evidentohen dhe defektet në pilotimin e votimit dhe numërimit elektronik, por ndërkohë konsiderohet një avantazh shpejtësia dhe efikasiteti i

tij në raport me numërimin manual.¹⁰

Shpërdorimi i burimeve publike një zë vend të rëndësishëm në rekomandimet e KSHH-së, ku theksohet nevoja e rishikimit të Kodit për të parandaluar këtë fenomen. “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale, vlerësojmë se duhet të rishikohet në parashikimet e Kodit Zgjedhor duke e shtrirë këtë ndalim që prej datës së dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe mos e kufizuar atë në raport me faktin nëse një parti politike është regjistruar apo jo si subjekt zgjedhor”, rekomandon KSHH.

“Qëndresa Qytetare” e fokuson raportin e saj te keqpërdorimi i burimeve publike, fenomen që ka shënuar 442 denoncime në KQZ, nga të cilat 345 nga shoqëria civile dhe 89 nga subjektet zgjedhore dhe vetëm 8 nga monitoruesit e KQZ-së.¹¹

Objekti i denoncimeve kishin të bënin me përdorimin e aseteve publike për qëllime zgjedhore, si shfrytëzim i burimeve njerëzore, përdorim i rrjeteve sociale të institucioneve dhe titullarëve dhe nxjerrja e akteve ligjore me përfitime për kategori sociale.

Nga këto denoncime, sipas QQ-së, ka vetëm 57 persona të ndëshkuar në total dhe masa e gjobës së vendosur shkoj në total

⁹ KRIIK, (2023). Raport Paraprak mbi Transparencën dhe Kontrollin mbi Financimin e Fushatës për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 Majit 2023. Marrë nga: <https://kriik.al/home/2023/07/31/raport-paraprak-financim-zgjedhje14maj23/> parë më: 08.02.2024.

¹⁰ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (2023). Raport Përfundimtar mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Monitorimit të Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore. Marrë nga: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/09/Raporti-Perfundimtar-per-Monitorimin-e-Zgjedhjeve-_19-Shtator-2023.pdf, parë më: 08.02.2024.

¹¹ Qëndresa Qytetare, (2023). Keqpërdorimi i Burimeve Shtetërore në Zgjedhjet Vendore 2023. Marrë nga: <https://qq.com.al/index.php/2024/01/11/keperdorimi-i-burimeve-shteterore-ne-zgjedhjet-vendore-2023/>, parë më: 08.02.2024.

2,048,000 lekë (20 000 euro).

Ndërkohë, në veprimtaritë publike QQ vëren se ka një nivel më të lartë ndërgjegjësimi për raportimin e tyre nga institucionet publike, por gjithsesi nga 516 veprimtari të hetuara vetëm 20 prej tyre u sanksionuan.

Edhe QQ rekomandon rishikimin e neneve të Kodit Zgjedhor, duke hequr nga dispozita relevante e Kodit Zgjedhor termin “përdorim i detyrues” për administratën publike në zgjedhje dhe duke qartësuar sanksionet për titullarët përgjegjës për raportimin e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja.

Duke iu referuar akteve të qeverisë për rritje pagash e pensionesh, rekomandohet që ligji të jetë i barabartë duke qartësuar zbatimin e dispozitës për çdo palë zgjedhje, vendore dhe parlamentare.

1.2 Kuadri ligjor

Zgjedhjet në Shqipëri rregullohen nga Kushtetuta¹², Kodi Zgjedhor¹³, ligji “Për partitë politike”¹⁴ dhe ligji “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”¹⁵ ose siç njihet ndryshe ligji i dekriminalizimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Në ndryshimet e Kodit Zgjedhor në vitin 2020, KQZ-ja doli si një institucion i riformatuar, i përbërë nga tre organe drejtuese: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si organ monokratik (me kompetenca ekzekutive) dhe dy organe kolegjiale Komisioni Rregullator (miraton aktet me karakter normativ) dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (shqyrton ankimimet administrative dhe vendos sanksione për shkelje të ligjit zgjedhor). Në zbatim të ligjit, Komisioni Rregullator nxjerr akte nënligjore për të detajuar rregullat për zgjedhjet.

Mes të tjerash, Kodi Zgjedhor i ndryshuar me marrëveshje politike në vitin 2020, parashikoi një sërë rregullimesh të reja në kuadrin ligjor që rregullon financimin e zgjedhjeve dhe fushatës, përfshirë edhe rregullat për parandalimin e përdorimit të burimeve publike në fushatë.

Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore

Ligji “Për partitë politike” parashtron rregullimet e përgjithshme sa i përket financimit të partive politike për të ushtruar veprimtarinë e tyre. Sipas këtij ligji, partitë politike i krijojnë të

¹² Ligji nr. 8417, dt. 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

¹³ Ligji nr. 10019, dt. 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

¹⁴ Ligji nr. 8580, dt. 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar

¹⁵ Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar

ardhurat e tyre nëpërmjet:

- a) Kontributeve të anëtarësisë;
- b) Fondeve publike, që përfshijnë ndihmën financiare nga buxheti i shtetit; dhe
- c) Fondeve jopublike, ku përfshihen dhurimet në para, natyrë dhe shërbime, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si dhe transaksione të tjera financiare.

Partitë përfitojnë fonde publike nga buxheti i shtetit për veprimtarinë e tyre vjetore sipas rregullave të parashikuara nga ligji “Për partitë politike”. Fondi shpërndahet në raport me numrin e deputetëve dhe numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare. Dhënia e ndihmës financiare vjetore nga buxheti i shtetit kushtëzohet me dorëzimin e raportit financiar vjetor për vitin paraardhës nga partia politike.

Sipas ligjit “Për partitë politike”, partitë politike nuk mund të financohen nga qeveri dhe ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror. Ata lejohet të marrin dhurata dhe financime nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, organizata e fondacione politike, vendase dhe të huaja, si dhe nga shtetasit shqiptarë dhe personat juridikë vendas.

Nga ana tjetër, **Kodi Zgjedhor** rregullon financimin e fushatës

dhe subjekteve zgjedhore dhe rendit katër burime të financimit të fushatës:

- a) buxheti i shtetit;
- b) të ardhurat e vetë subjektit¹⁶;
- c) dhuratat (monetare, në natyrë ose në shërbime);
- d) huatë dhe kreditë që marrin partitë politike dhe kandidatët e tyre.

Për qëllime të financimit të fushatës së tyre, subjektet zgjedhore mund të marrin fonde jopublike vetëm nga personat fizikë dhe juridikë vendas dhe shuma (ose kundërvlera në sende apo shërbime) që mund t’i japë një person fizik ose juridik subjektit zgjedhor, apo kandidatëve të tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë. Kjo vlerë, ndonëse nuk përcaktohet shprehimisht në Kod, zbatohet edhe për kandidatët që vetëfinancojnë fushatën e tyre. Donacionet e huaja nuk lejohen. Me qëllim identifikimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit, ndikimit të paligjshëm në politikë dhe abuzimin me burimet shtetërore, Kodi Zgjedhor vendos një sërë kufizimesh për dhuruesit kur kanë përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione, ushtrojnë veprimtari në fushën e medias, apo kanë detyrime monetare ndaj institucioneve publike.

¹⁶ Këtu përfshihen kontributet e anëtarësisë, si dhe të ardhura të tjera që subjekti gjeneron nga veprimtaria fitimprurëse nëpërmjet botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve apo qiradhënies, sipas ligjit për partitë politike.

Shpenzimet në fushatë

Kodi vendos kufizime sa i përket shpenzimeve që mund të kryejë çdo subjekt zgjedhor në kuadër të fushatës – kjo shumë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i shumës më të lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike. Limiti mbi shpenzimet ka si qëllim kryesor ruajtjen e “barazisë së armëve” mes garuesve në zgjedhje.

Raportimi i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditimi

Partitë politike duhet të dorëzojnë pranë KQZ-së raporte financiare vjetore, si dhe raportet financiare për fushatën zgjedhore në vite zgjedhore kur garojnë si subjekte, brenda afateve ligjore përkatëse. Raportet plotësohen sipas formatit të standardizuar të miratuar nga KQZ-ja. Raportet financiare për fushatën zgjedhore duhet t'i dorëzohen KQZ-së brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. I njëjti rregull vlen edhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit ose kandidatët e pavarur. Kandidatët e listave shumëëmërore (dhe kandidatët për kryetarë bashkie në rastin e zgjedhjeve vendore) gjithashtu plotësojnë raportet financiare sipas formatit të cilat i dorëzohen partive politike për të cilat garojnë brenda 30 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. KQZ-ja i publikon këto raporte në faqen e vet zyrtare.

Për miratimin e formateve të standardizuara dhe me qëllim udhëzimit të subjekteve garuese për detyrimet e raportit financiar, Komisioni Rregullator miraton aktet nënligjore përkatëse. Në zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të 14 majit 2023, këto akte përbëheshin nga:

1. Vendimi nr. 15, dt. 07.04.2023 për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore; dhe
2. Vendimi nr. 20, dt. 20.04.2023 për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Për herë të parë në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, subjektet zgjedhore i dorëzuan raportet financiare nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar.

Një moment i rëndësishëm që lidhet me mbikëqyrjen financiare që ushtron KQZ-ja ndaj subjekteve zgjedhore është auditimi i raporteve të dorëzuara nga ato. Ky funksion kryhet nga auditues kontabël të licencuar (auditues ligjorë) të cilët caktohen me short nga KQZ-ja. Raporti i auditimit me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse i dorëzohet KQZ-së brenda afateve përcaktuara. Më pas, KQZ-ja kryen procesin e verifikimit dhe kontrollit nëpërmjet krahasimit të të dhënave në raportet financiare të fushatës dhe raporteve të auditimit. Në përfundim të procesit dhe në bazë të gjetjeve, KQZ-ja merr masat përkatëse që mund të përbëjnë

sanksione administrative për subjektet zgjedhore që gjehen në shkelje të rregullave të financimit të fushatës.¹⁷



Keqpërdorimi i burimeve publike dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së fushatës

Kodi Zgjedhor, në nenin 91, ndalon përdorimin e burimeve publike në fushatë duke përfshirë këtu burimet njerëzore, financiare dhe logjistike në fushatë, me përjashtim të rasteve të përligjura. Neni 92 gjithashtu detyron institucionet publike që të raportojnë të gjitha aktivitetet publike në KQZ duke filluar nga katër muaj para datës së zgjedhjeve. Kuadri ligjor, në këtë aspekt, plotësohet nga vendimi nr. 9/2020¹⁸ i Komisionit Rregullator i cili detajon rregullat për raportimin e veprimtarive publike të institucioneve publike, përcakton veprimtaritë e ndaluara dhe monitorimin e përdorimit të burimeve njerëzore në zgjedhje.

Në kuadër të ushtrimit të rolit të vet mbikëqyrës, katër muaj para datës së zgjedhjeve KQZ-ja emëron monitoruesit e fushatës, të cilët raportojnë shkeljet e vëzhguara, sidomos në kuadër të keqpërdorimit të burimeve publike, zhvillimin e veprimtarive

publike të paraportuara ose të ndaluara nga KQZ-ja, vendosjen e parregullt të materialeve propagandistike, etj. Nga ana tjetër, fushata zgjedhore në media monitorohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i cili raporton rregullisht në KQZ për kohëzgjatjen e fushatës.

Me ndryshimin e Kodit Zgjedhor në vitin 2020, u zgjeruan kompetencat e KQZ-së në lidhje me hetimin administrativ dhe njëkohësisht iu dha e drejta e denoncimit të shkeljeve të vëzhguara gjatë fushatës edhe publikut përfshirë këtu qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Këto të fundit, si në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, ashtu edhe në ato vendore të 2023, e kanë përdorur aktivisht portalin e denoncimeve për të sjellë në vëmendjen e KQZ-së raste të vëzhguara të shkeljeve, sidomos në kuadër të abuzimit me burimet shtetërore. Në shumë raste, denoncimet e organizatave janë bërë shkas për fillimin e hetimit administrativ dhe vendimmarrjen e KQZ-së, e cila ka rezultuar edhe në sanksione për subjektet shkelëse.

¹⁷ Neni 173, Kodi Zgjedhor

¹⁸ Vendimi nr. 9, dt. 24.12.2020 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

Vendosja e materialeve propagandistike

Nënenin 79, Kodi Zgjedhor përcakton rregullat sa i përket afishimit dhe vendosjes së materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Sipas ligjit, subjektet zgjedhore mund të vendosin materiale propagandistike vetëm në zonat e përcaktuara me vendim të kryetarit të bashkisë në territorin e bashkisë përkatëse. Ndërkohë, çdo material tjetër propagandistik statik nuk mund të vendoset në një largësi më shumë se 5 metra nga zyra elektorale e subjektit zgjedhor. Ligji mandaton Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për të hequr çdo material propagandistik që konstatohet në kundërshtim me nenin 79 të Kodit.

2. Qëllimi dhe metodologjia e raportit

2.1. Qëllimi i raportit

Ky raport ka si qëllim analizimin gjithëpërfshirës të të ardhurave dhe shpenzimet e deklaruara nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore 2023, duke u bazuar në raportet financiare të partive politike të dorëzuara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të publikuara në Platformën Elektronike të Raportimit Financiar¹⁹ të këtij institucioni në nëntor 2023.

Ky raport ka për qëllim të ndihmojë gazetarët, ekspertët dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit për të pasur të dhëna të hapura dhe transparente lidhur me financat e partive politike, si dhe të mundësojë analiza të mëtejshme lidhur me kostot e fushatës më të fundit elektorale në vend.

Të dhënat e deklaruara nga subjektet zgjedhore do t'u mundësojnë grupeve të ndryshme të vëzhguesve vendorë të validojnë gjetjet e tyre nga monitorimi në terren, si dhe krahasimin e raportimeve financiare me të dhënat e hapura të

¹⁹ Platforma Elektronike e Raportimit Financiar: <https://fpp.kqz.gov.al/kreu/reports>

deklaruara nga media dhe burime të sigurta mbi të ardhurat dhe shpenzimet e partive politike.

Gjithashtu, gjetjet e këtij raporti kanë për qëllim të nxisin KQZ-në dhe aktorët e tjerë në përmirësimin e sistemit të deklarimit të raporteve financiare për fushatat zgjedhore, sistemin e auditimit të këtyre të fundit, si dhe vendosjen e sanksioneve në rastet e identifikimit të problematikave në raportim.

2.2. Metodologjia

Ky seksion përshkruan mënyrën e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore të vitit 2023. Metodologjia është hartuar në mënyrë që të sigurojë një analizë transparente, të saktë dhe gjithëpërfshirëse të transaksioneve financiare të partive politike në zgjedhjet për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiakë, duke monitoruar lëvizjet financiare për të identifikuar shkelje të rregullave të financimit të partive politike dhe kandidatëve gjatë fushatës zgjedhore dhe të rregullave të tjera të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Mbledhja e të dhënave

Raportet financiare: Mbledhja e të dhënave për këtë studim u bazua në raportet financiare të partive politike dhe kandidatëve për fushatën zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2023. Studimi bazohet në raportet financiare të 20 subjekteve zgjedhore²⁰ që morën pjesë në zgjedhjet vendore. Këto raporte përfshijnë të gjithë vetëdeklarimet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor mbi të ardhurat dhe shpenzimet gjatë fushatës.

Të dhënat e hapura: Autorët e këtij studimi gjithashtu përdorën të dhëna të hapura nga media dhe burime të tjera, në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e partive politike. Për shembull një burim i rëndësishëm ka qenë Libraria e Shpenzimeve për Reklama Politike e rrjetit social Facebook.

Analiza e të dhënave

Analiza financiare: Autorët përdorën teknikat e analizës financiare për të hulumtuar të ardhurat, shpenzimet dhe bilancin financiar të subjekteve politike pjesëmarrëse dhe kandidatëve në zgjedhjet vendore.

Verifikimi i kryqëzuar: Verifikimi në mënyrë të kryqëzuar i të

²⁰ Sipas databazës së KQZ, deri në 30 Qershor 2024 kishin dorëzuar raportet e tyre mbi fushatën e 14 Maj 2023, 28 subjekte zgjedhore, nga të cilat tetë subjekte kanë deklaruar 0 të ardhura dhe shpenzime, duke u përjashtuar nga analiza e mëtejshme e të dhënave.

dhënat financiare të marra nga burime të ndryshme (p.sh., duke krahasuar të dhënat e Librarisë së Reklamave të Facebook-ut dhe shpenzimet e deklaruar nga partitë politike në KQZ për reklama në rrjetet sociale) për të siguruar saktësinë dhe për të zbuluar dallimet në deklaramë të subjekteve të ndryshme.

Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore: Vlerësimi i aktiviteteve financiare të partive politike në raport me kuadrin ligjor që rregullon financimin e zgjedhjeve për të identifikuar shkeljet e mundshme ose hapësirat e mospërputhshmërisë me Kodin Zgjedhor.

Mjetet e monitorimit

Databaza: Autorët e këtij studimi krijuan një bazë të dhënash elektronike në programin “Excel”, ku u hodhën të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet financiare të partive politike gjatë fushatës zgjedhore.

Pivot tables: Autorët e këtij studimi përdorën funksionin e tabelave “Pivot” në Excel për të përmbledhur, filtruar dhe analizuar të dhënat financiare të deklaruar nga partitë politike dhe kandidatët për kryetar bashkie gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2023.

Konsiderata etike

Mbrojtja e të dhënave personale: Autorët e këtij studimi ndërmorën masa për të mbrojtur të dhënat personale dhe konfidenciale të mbledhura gjatë analizimit të raporteve financiare të partive politike në zgjedhjet vendore.

Transparenca: Ky studim përpiqet t’i bëjë sa më të qarta dhe transparente burimet e të dhënave të përdorura si dhe metodologjinë e analizës financiare.

Paanshmëria: Autorët treguan kujdes gjatë mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për të treguar paanshmëri dhe trajtim të barabartë për subjektet e ndryshme politike të marra në analizë.

Kufizime:

Aksesi në të dhëna: Raportet financiare janë shkarkuar nga faqja elektronike e KQZ-së në fund të muajit Qershor 2024. Ato nuk reflektojnë ndryshimet në raportet financiare të cilat mund të jenë kryer pas datës 30 Qershor 2024, nëse ka të tilla, ose gjetjet e raporteve të auditit të zhvilluar për këto subjekte dhe të publikuara në databazën e KQZ-së në periudhën Maj – Gusht 2024.

Cilësia e të dhënave: Për shkak se raportet financiare të partive politike dhe kandidatëve në zgjedhje bazohen në vetëdeklarimet

e subjekteve zgjedhore, ato jodomosdoshmërisht reflektojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në fushatën për zgjedhjet vendore të vitit 2023, të cilat mund të përfshijnë dhe shpenzime nga palë të treta.

Raportimi dhe rekomandimet

Përfshirja e palëve të interesuara: Përpara publikimit të studimit, autorët e diskutuan metodologjinë dhe të dhënat e mbledhura me palët të interesuara, përfshirë përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ekspertë zgjedhorë, si dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet dhe financat e partive politike.

3. Gjetjet kryesore

Bazuar në databazën e ngritur dhe përpunimin e të dhënave të deklaruara nga subjektet zgjedhore lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës së tyre dhe të publikuara në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më poshtë në këtë seksion përmbledhen gjetjet kryesore.

3.1. Të ardhurat e subjekteve zgjedhore

Nga raportet financiare të deklaruara pranë KQZ-së nga 20 subjektet kryesore zgjedhore për fushatën e vitit 2023, të ardhurat totale janë në vlerën 285,654,138.77 ALL (përafërsisht 2.57 milionë Euro²¹). Nga këto të ardhura, pjesën kryesore (96.24%) e zënë të ardhurat lidhur me tre zëra kryesorë, përkatësisht “Të ardhura të krijuara nga subjekti”, të cilat përlllogaritën në 42.73% të shumës totale të të ardhurave, “Financime publike” me 38.17% dhe “Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore” me 15.34%.

Ndërkohë, zërat e tjerë lidhur me “Dhurime në natyrë”, “Financime jopublike” dhe “Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore”

²¹ Kursi mesatar mujor i këmbimit për muajin Maj 2024 sipas Bankës së Shqipërisë ka qenë 1 Euro = 111.1 ALL, https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

kontribuojnë për 3.76% të të ardhurave totale, ndërsa asnjë nga subjektet nuk kanë deklaruar se kanë marrë “Hua dhe kredi” për të mbuluar financimin e fushatës, siç detajohet dhe në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Të ardhurat e deklaruar nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023 dhe pesha e secilit zë të deklaruar

Zëri i të ardhurave	Vlera për të gjithë subjektet	% ndaj të ardhurave totale
Të ardhura të krijuara nga subjekti	122,071,251.00	42.73%
Financime publike	109,031,815.00	38.17%
Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	43,816,856.57	15.34%
Dhurime në natyrë	5,932,818.00	2.08%
Financime jopublike	4,399,166.68	1.54%
Huatë dhe kreditë	-	0.00%
Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	402,231.52	0.14%
Të ardhurat totale	285,654,138.77	100.00%

Të dhënat tregojnë se ka ndryshime të mëdha mes shumës së të ardhurave të deklaruar nga subjekte të ndryshme, ku pjesën më të madhe (78.88%) e zënë dhe tre subjektet kryesore garuese: Partia Socialiste me 42.83%, Partia e Lirisë me 22.79% dhe Partia Demokratike me 13.26% të të ardhurave totale të të gjithë subjekteve.

Tabela 2: Të ardhurat e deklaruara nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023 dhe pesha e secilit subjekt ndaj të ardhurave totale

Subjekti zgjedhor	Të ardhurat në ALL	% ndaj totalit të të ardhurave
Partia Demokracia Sociale	1,130,000.00	0.40%
Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	292,500.00	0.10%
Partia Republikane Shqiptare	4,641,779.00	1.62%
Nisma Thurje	7,066,029.68	2.47%
Partia Agrare Ambientaliste	8,148,647.00	2.85%
Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	10,022,458.00	3.51%
Partia Socialiste	122,341,857.00	42.83%
Partia e Gjelbër	800,000.00	0.28%
Bindja Demokratike	639,799.00	0.22%
Partia Demokratike	37,880,093.00	13.26%
Partia SocialDemokrate	12,266,269.00	4.29%
Partia e Lirisë	65,113,202.09	22.79%
Partia e Lëvizjes së Legalitetit	8,018,647.00	2.81%
Partia Balli Kombëtar	42,000.00	0.01%
Fryma e Re Demokratike	1,707,693.00	0.60%

Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	3,075,792.00	1.08%
Balli Kombëtar Demokrat	1,400,000.00	0.49%
Partia Demokristiane	35,000.00	0.01%
Lëvizja e Re	28,000.00	0.01%
Lëvizja Bashkë	1,004,373.00	0.35%
Të ardhurat totale	285,654,138.77	100.00%

Gjithashtu, ndryshime të rëndësishme mes deklarimeve të subjekteve zgjedhore lidhur me të ardhurat vihen re dhe brenda zërave specifike të deklaramit. Për shembull, Partia Socialiste ka deklaruar pjesën dërrmuese të “Dhurimeve në natyrë” me 89.35% të totalit të mbledhur nga të gjitha subjektet bashkë, ndërsa bashkë me Partinë e Lirisë kanë deklaruar mbi 99% të zërit të “Të ardhurave totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore”.

Nga ana tjetër, kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë, pavarësisht se të shumtë në numër, deklarohet se kanë mbledhur vetëm 0.14% të të gjithë totalit të të ardhurave të subjekteve zgjedhore, nga të cilat, peshën më të madhe e mbajnë kandidatët e listave nën siglën e Partisë së Lirisë (82.6%).

Tabela 3: Të ardhurat e deklaruara nga tre subjektet kryesore zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023 dhe pesha e secilit zë të deklaruar

Zëri i të ardhurave	Partia Socialiste		Partia e Lirisë		Partia Demokratike	
	<i>Të ardhurat në ALL</i>	<i>% ndaj totalit të subjekteve</i>	<i>Të ardhurat në ALL</i>	<i>% ndaj totalit të subjekteve</i>	<i>Të ardhurat në ALL</i>	<i>% ndaj totalit të subjekteve</i>
Të ardhura të krijuara nga subjekti	62,968,160.00	51.58%	15,484,210.00	12.68%	12,916,509.00	10.58%

Financime publike	42,833,467.00	39.29%	15,594,216.00	14.30%	24,963,584.00	22.90%
Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	10,969,230.00	25.03%	32,444,326.57	74.05%	-	0.00%
Dhurime në natyrë	5,301,000.00	89.35%	401,818.00	6.77%	-	0.00%
Financime jopublike	270,000.00	6.14%	856,400.00	19.47%	-	0.00%
Huatë dhe kreditë	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%
Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	0.00%	332,231.52	82.60%	-	0.00%
Të ardhurat totale	122,341,857.00	42.98%	65,113,202.09	22.87%	37,880,093.00	13.31%

Përveç Partisë Socialiste dhe Partisë së Lirisë, vetëm Fryma e Re Demokratike ka deklaruar të ardhura në më shumë se dy zëra, ndërsa shumica e subjekteve zgjedhore kanë deklaruar të ardhura nga dy zëra (9 subjekte) ose vetëm një (8 subjekte).

Të dhënat e detajuara për secilin zë të ardhurash dhe shpenzimesh për çdo subjekt zgjedhor i gjeni në Aneksin I të këtij raporti.

3.2. Shpenzimet e subjekteve zgjedhore

Nga raportet financiare të deklaruara pranë KQZ-së nga 20 subjektet kryesore zgjedhore për fushatën e vitit 2023, shpenzimet totale kapin vlerën 263,347,054.09 ALL (përafërsisht 2.4 milionë Euro), duke krijuar një balancë pozitive në vlerën 22,307,084.68 ALL krahasuar

me të ardhurat e gjeneruara. Nga kjo diferencë, shuma prej 879,222.00 ALL është deklaruar nga subjekti Partia SocialDemokrate si vlerë e kthyer ndaj financimit publik.

Më shumë se një e treta e shpenzimeve totale (83,614,677.00 ALL) është deklaruar nën zërat “Shpenzimet administrative” që zënë 18.95% dhe ‘Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë’ me 12.80% të shpenzimeve totale.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se shpenzimet kryesore vijojnë të deklarohen lidhur me reklamimin dhe prezencën në media dhe materiale promocionale, ndër të cilat shpenzimet kryesore kategorizohen nën zërat për “Media” (19.34%), “Materiale promocionale” (10.42%), “Media Sociale” (10.03%), të cilëve nëse u shtohet dhe vlera e “Detyrime të papaguara – Media” (1.97%), kapin vlerën totale prej 109,942,363.00 ALL ose 41.75% të të gjitha shpenzimeve të deklaruara.

Tabela 4: Shpenzimet e deklaruara nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023 dhe pesha e secilit zë të deklaruar

Zëri i shpenzimeve	Vlera për të gjithë subjektet	% ndaj shpenzimeve totale
Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	43,689,771.57	16.59%
Transport	10,521,279.00	4.00%
Materiale promocionale	27,436,674.00	10.42%
Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë	33,708,274.00	12.80%
Shpenzimet administrative	49,906,403.00	18.95%
Media	50,924,552.00	19.34%
Media Sociale	26,412,611.00	10.03%
Konsulenca	3,572,500.00	1.36%
Shpenzime zyre elektorale	4,425,214.00	1.68%

Botime	424,200.00	0.16%
Shpenzime indirekte / dhurimet në natyrë	5,932,818.00	2.25%
Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëëmërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	402,231.52	0.15%
Reklamime në natyrë	22,000.00	0.01%
Botime / Publikime	800,000.00	0.30%
Detyrime të papaguara - Media	5,168,526.00	1.96%
Shpenzime totale	263,347,054.09	100.00%

Të dhënat e analizuara tregojnë se nën kategorinë e shpenzimeve, pabarazitë mes subjekteve zgjedhore janë dhe më të theksuara krahasuar me të ardhurat e mbledhura. Tre subjektet kryesore garuese në zgjedhjet e 14 majit 2023 kanë deklaruar vlerën 228,793,009.09 ALL (përafërsisht 2.06 milionë Euro) ose 87.14% të të gjithë shpenzimeve për fushatë, përkatësisht Partia Socialiste me 46.55%, Partia e Lirisë me 26.16% dhe Partia Demokratike me 14.43%.

Këto ndryshime në përqindjen e të ardhurave dhe shpenzimeve janë reflektuar dhe në balancat e raporteve financiare, ku subjekti Partia e Lirisë është i vetmi që ka deklaruar një balancë negative (3,582,692.00 ALL), e cila është regjistruar si vlerë e papaguar ndaj mediave.

Tabela 5: Shpenzimet e deklaruar nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023, pesha e secilit subjekt ndaj shpenzimeve totale dhe balanca e regjistruar mes të ardhurave dhe shpenzimeve.

Subjekti zgjedhor	Shpenzimet në ALL	% ndaj totalit të shpenzimeve	Balanca mes të ardhurave dhe shpenzimeve
Partia Demokracia Sociale	1,130,000.00	0.43%	-
Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	292,500.00	0.11%	-
Partia Republikane Shqiptare	4,641,779.00	1.76%	-

Nisma Thurje	1,760,272.00	0.67%	5,305,757.68
Partia Agrare Ambientaliste	7,982,722.00	3.03%	165,925.00
Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	4,862,484.00	1.85%	5,159,974.00
Partia Socialiste	122,217,022.00	46.41%	124,835.00
Partia e Gjelbër	800,000.00	0.30%	-
Bindja Demokratike	639,799.00	0.24%	-
Partia Demokratike	37,880,093.00	14.38%	-
Partia SocialDemokrate	3,152,546.00	1.20%	9,113,723.00*
Partia e Lirisë	68,695,894.09	26.09%	(3,582,692.00)
Partia e Lëvizjes së Legalitetit	2,530,019.00	0.96%	5,488,628.00
Partia Balli Kombëtar	42,000.00	0.02%	-
Fryma e Re Demokratike	1,396,984.00	0.53%	310,709.00
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	3,075,792.00	1.17%	-
Balli Kombëtar Demokrat	1,400,000.00	0.53%	-
Partia Demokristiane	26,700.00	0.01%	8,300.00
Lëvizja e Re	28,000.00	0.01%	-
Lëvizja Bashkë	792,448.00	0.30%	211,925.00
Shpenzimet totale	263,347,054.09	100.00%	22,307,084.68

* Partia SocialDemokrate ka deklaruar shumën prej 879,222.00 ALL si vlerë e kthyer ndaj financimit publik.

Ndryshime të rëndësishme mes deklarimeve të subjekteve zgjedhore lidhur me shpenzimet vihen re dhe brenda zërave specifikë të deklarimit. Për shembull, në përputhje dhe me deklarimin e të ardhurave, shpenzimet e regjistruara nga Partia Socialiste dhe Partia e Lirisë nën zërin “Shpenzime indirekte / dhurimet në natyrë” zënë 96.12% të shpenzimeve të të gjithë subjekteve për këtë nënkategori.

Tabela 6: Shpenzimet e deklaruar nga tre subjektet kryesore zgjedhore gjatë fushatës së vitit 2023 dhe pesha e secilit zë të deklaruar

Zëri i shpenzimeve	Partia Socialiste		Partia e Lirisë		Partia Demokratike	
	Shpenzimet në ALL	% ndaj totalit të subjekteve	Shpenzimet në ALL	% ndaj totalit të subjekteve	Shpenzimet në ALL	% ndaj totalit të subjekteve
Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	10,844,395.00	24.82%	32,444,326.57	74.26%	-	0.00%
Transport	2,949,068.00	28.03%	-	0.00%	-	0.00%
Materiale promocionale	7,914,700.00	28.85%	3,150,546.00	11.48%	9,439,708.00	34.41%
Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë	6,520,100.00	19.34%	9,567,110.00	28.38%	13,725,155.00	40.72%
Shpenzimet administrative	21,132,403.00	42.34%	15,889,516.00	31.84%	8,620,230.00	17.27%
Media	44,627,966.00	87.64%	-	0.00%	2,670,000.00	5.24%
Media Sociale	21,008,514.00	79.54%	981,137.00	3.71%	2,215,000.00	8.39%
Konsulenca	-	0.00%	2,270,000.00	63.54%	-	0.00%
Shpenzime zyre elektorale	1,918,876.00	43.36%	76,517.00	1.73%	1,210,000.00	27.34%
Botime	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%

Shpenzime indirekte / dhurimet në natyrë	5,301,000.00	89.35%	401,818.00	6.77%	-	0.00%
Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	0.00%	332,231.52	82.60%	-	0.00%
Reklamime në natyrë	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%
Botime / Publikime	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%
Detyrime të papaguara - Media	-	0.00%	3,582,692.00	69.32%	-	0.00%
Shpenzimet totale	122,217,022.00	46.41%	68,695,894.09	26.09%	37,880,093.00	14.38%

Të dhënat e analizuar tregojnë se subjektet kryesore, por dhe subjektet e tjera garuese kanë deklaruar shuma të vogla ose asnjë shpenzim në zëra si “Transport”, “Botime” dhe “Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumë emërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore”.

Gjithashtu, asnjë nga subjektet kryesore garuese nuk ka deklaruar shpenzime lidhur me zërin “Reklamime në natyrë”, në të cilin përfshihen sipas Vendimit nr. 20 të KQZ-së, datë 20.04.2023, kostot e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara jashtë në natyrë, përfshirë këtu kostot për billborde, dritat dhe forma të tjera të aktiviteteve jashtë në natyrë.

Të dhënat e detajuara për secilin zë të ardhurash dhe shpenzimesh për çdo subjekt zgjedhor i gjeni në Aneksin I të këtij raporti.

Shpenzimet e kandidatëve për kryetar²²

Nga totali i shpenzimeve të raportuara nga të gjitha subjektet zgjedhore, shuma prej 44,092,003.09 ALL është deklaruar nën shpenzimet e drejtpërdrejta të kandidatëve për kryetarë të bashkisë dhe atyre për anëtarë të këshillave bashkiakë, me përkatësisht 16.59% dhe 0.15% të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e regjistruara nga Partia Socialiste dhe Partia e Lirisë nën zërin “Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore” të këtyre dy subjekteve zënë mbi 99% të vlerës së deklaruar nga të gjithë kandidatët bashkë. Pavarësisht se të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar nga subjektet nën këtë zë janë në përputhje me përqindjen e kandidatëve për kryetarë që garonin nën siglën e këtyre dy subjekteve, me përkatësisht 121 nga 144 të tillë, të dhënat e detajuara tregojnë ndryshime të mëdha mes kandidatëve dhe bashkive ku ata garonin.

Për shembull, vlera më e madhe e shpenzimeve të deklaruar nga një kandidat, 12,907,900.68 ALL ose më shumë se një e katërta e të gjithë shpenzimeve të deklaruar nga të 144 kandidatët, i përket raportit të dorëzuar nga z. Belind Këlliçi, i cili garonte nën siglën e Partisë së Lirisë, pjesë e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” në bashkinë Tiranë. Për të njëjtën bashki, kandidatët e Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Bashkë kanë deklaruar zero shpenzime.

Tabela 7: Shpenzimet e deklaruar nga kandidatët për kryetar të ndara sipas bashkive kryesore të vendit.

	Partia Socialiste	Partia e Lirisë	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
Bashkia Durrës	75,859.00	2,192,343.00	-
Bashkia Elbasan	35,894.00	1,070,550.00	-
Bashkia Fier	138,910.00	196,157.00	-
Bashkia Korçë	381,000.00	442,615.00	-
Bashkia Shkodër	250,000.00	745,441.00	-
Bashkia Tiranë	-	12,907,900.68	266,550.00
Bashkia Vlorë	697,757.00	547,945.00	-

Listën e plotë të shpenzimeve të deklaruar nga kandidatët në të gjitha bashkitë e vendit e gjeni në Aneksin II të këtij raporti.

²² Në këtë nënseksion përfshihen vetëm deklaratimet e kryera nga subjektet zgjedhore mbi shpenzimet e kandidatëve që garonin nën siglën e tyre. Këto deklarime mund të mos përputhen me deklaratimet individuale të dorëzuara nga vetë kandidatët pranë KQZ-së.

Shpenzimet për median dhe rrjetet sociale

Shpenzimet për Median

Bazuar në analizën e shpenzimeve të deklaruar nga subjektet zgjedhore, totali i deklaruar për kostot e prodhimit dhe transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike, blerjen e kohës së transmetimit, si dhe komunikimet / reklamën në median online është në vlerën 56,093,078.00 ALL (përafërsisht 505,000 Euro). Në raportet, kjo shumë është e ndarë nën zërat për “Media” në vlerën 50,924,552.00 ALL dhe zërin e regjistruar nën “Detyrime të papaguara – Media” me vlerë 5,168,526.00 ALL. Këto dy zëra bashkë përbëjnë dhe shumën më të lartë ndër aktivitetet e deklaruar nga subjektet, me përkatësisht 19.34% dhe 1.96% të të gjithë shpenzimeve të deklaruar.

Pavarësisht shumës së konsiderueshme, vetëm gjashtë nga subjektet garuese në zgjedhjet e 14 majit 2023 kanë deklaruar shpenzime lidhur me median audiovizive dhe atë online, ku sërish pjesën më të madhe prej 90.71% të vlerës e kanë tre subjektet më të mëdha, pavarësisht pabarazive të mëdha dhe mes tyre, përkatësisht Partia Socialiste me 79.56%, Partia e Lirisë me 6.39% dhe Partia Demokratike me 4.76%.

Ndërkohë, vlera e harxhuar gjatë fushatës zgjedhore nga Partia e Lirisë, përkatësisht 3,582,692.00 ALL, bashkë me një pjesë të shpenzimeve të kryera në këtë drejtim nga Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë në shumën 1,585,834.00 ALL, kanë mbetur të palikuiduara deri në mbyllje të periudhës së raportimit

financiar, duke u nënkategorizuar si “Detyrime të papaguara”.

Tabela 8: Vlerat e deklaruar nga subjektet zgjedhore për shpenzimet në zërat ‘Media’ dhe ‘Detyrime të papaguara – Media’, si dhe pesha e tyre kundrejt vlerës totale të tyre.

	Media	Detyrime të papaguara - Media	% kundrejt totalit të të dy zërave
Partia Socialiste	44,627,966.00	-	79.56%
Partia e Lirisë	-	3,582,692.00	6.39%
Partia Demokratike	2,670,000.00	-	4.76%
Partia Republikane Shqiptare	1,863,326.00	-	3.32%
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	221,260.00	1,585,834.00	3.22%
Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet	1,542,000.00	-	2.75%
Totali i secili zë	50,924,552.00	5,168,526.00	
Totali i të dy zërave	56,093,078.00		

Analiza më e detajuar e linjave të shpenzimeve të deklaruar

nën këto dy zëra identifikon se pavarësisht se Vendimi nr. 20 i KQZ, datë 20.04.2023 përcakton se “Shpenzimet për median përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostove të fushatës zgjedhore dhe duhet të jenë të dokumentuara plotësisht, përfshirë informacionin lidhur me datat, kohën dhe kohëzgjatjen e saktë të të gjitha transmetimeve në media”, ky informacion është i munguar në raportet në dispozicion.

Nga transaksionet e raportuara, gjithsej vetëm 37 të tilla për të gjitha subjektet, vetëm dy transaksione në vlerën 400,000 ALL (0.71% e shpenzimeve për median) janë regjistruar ndaj përfituesve individë për realizim spotesh, ndërsa pjesa dërmuese e fondeve i kanë shkuar kompanive audiovizive. Nga këto 15 subjekte, tre prej tyre konsiderohen lokale (Radio Gjirokastra, TV Kopliku dhe STAR News RTV) dhe kanë marrë 0.28% të shpenzimeve për median, ndërsa pjesa dërmuese ka shkuar për 12 kompanitë audiovizive kombëtare dhe qendrore, përkatësisht mbi 99% e shpenzimeve.

Nga këto 12 kompani, transaksionet kryesore janë regjistruar ndaj televizioneve kombëtare TV Klan dhe Top Channel me 17.94% dhe 17.74% respektivisht, të ndjekur nga MTSC (Report TV me 13.37%), Euro Ballkan News (Euronews me 12.48%) dhe ABC News (12.47%). Ndërkohë, Partia e Lirisë i ka fokusuar reklamat e saj televizive vetëm tek Syri TV (3 DS & AF Entertainment), ku vlera totale prej 3,582,692 ALL është regjistruar si detyrim i pashlyer.

Tabela 9: Vlerat e deklaruara nga secili subjekt zgjedhor për shpenzimet në zërat “Media” dhe “Detyrime të papaguara – Media”, të ndara sipas furnitorit përfitues.

Furnitori	Partia Agrare Ambjent. e Shqipërisë	Partia Demokratike	Partia e Lirisë	Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet	Partia Republikane Shqiptare	Partia Socialiste	Total në ALL	% ndaj Totalit
3 DS & AF Entertainment			3,582,692		331,680		3,914,372	6.98%
ABC News						6,995,608	6,995,608	12.47%
A. B. PF		200,000					200,000	0.36%

Euro Ballkan News shpk						7,000,000	7,000,000	12.48%
Focus Media News shpk	221,260	2,120,000		742,000	410,808		3,494,068	6.23%
Media Vizion sha						4,000,000	4,000,000	7.13%
MTSC				500,000	234,747	6,765,368	7,500,115	13.37%
Ora News shpk 2023	1,585,834				100,000		1,685,834	3.01%
O. I.		200,000					200,000	0.36%
Panorama Group Sh.A				300,000	110,730		410,730	0.73%
Radio Gjirokastra						6,360	6,360	0.01%
Shqiptarja.com						234,630	234,630	0.42%
STAR News RTV		100,000					100,000	0.18%
TOP CHANNEL					324,000	9,626,000	9,950,000	17.74%
TV KLAN					351,361	9,714,330	10,065,691	17.94%
TV Klan Plus						285,670	285,670	0.51%
TV Kopliku		50,000					50,000	0.09%
Total në ALL	1,807,094	2,670,000	3,582,692	1,542,000	1,863,326	44,627,966	56,093,078	

Mungesa e detajeve të ofruara lidhur me transaksionet e regjistruara ndaj kompanive mediatike e bën të pamundur ndarjen e këtyre shpenzimeve mes transmetimeve audiovizive dhe atyre për median online të këtyre kompanive, megjithatë, në listën e furnitorëve nuk është regjistruar asnjë kompani që zotëron vetëm media online (digital native).

Shpenzimet për Median Sociale

Shuma totale e shpenzimeve të deklaruar nën zërin “Media Sociale” nga të gjitha subjektet garuese është në vlerën 26,412,611.00 ALL, duke zënë 10.03% të shpenzimeve të kryera në fushatën e 14 majit 2023.

Pavarësisht se fushata në rrjetet sociale ka pasur një përdorim të gjerë gjatë zgjedhjeve të dekadës së fundit, vetëm 8 prej subjekteve zgjedhore deklaruan shpenzime në këtë drejtim. Peshën më të madhe në deklarimet e këtij zëri e zë Partia Socialiste, me pothuaj 80 për qind të shumës totale, pasuar nga Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë.

Tabela 10: Vlera e shpenzimeve e deklaruar për zërin “Media Sociale” sipas subjektit zgjedhor

	Shpenzimet për Media Sociale	% ndaj totalit të këtij zëri
Partia Socialiste	21,008,514.00	79.54%

Partia Demokratike	2,215,000.00	8.39%
Partia e Lirisë	981,137.00	3.71%
Bindja Demokratike	639,799.00	2.42%
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	546,792.00	2.07%
Nisma Thurje	435,243.00	1.65%
Partia e Lëvizjes së Legalitetit	360,000.00	1.36%
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	25,500.00	0.10%
Lëvizja Bashkë	200,626.00	0.76%
Totali i shpenzimeve për Media Sociale	26,412,611.00	100.00%

Megjithatë, një analizë më e detajuar e linjave të shpenzimeve të deklaruar nën këtë zë identifikon larminë e shërbimeve të përfshira, pavarësisht se Vendimi nr. 20 i KQZ-së, datë 20.04.2023 e përkufizon “Shpenzimet e mediave sociale do të përfshijnë shpenzimet e bëra për reklamim në platformat e mediave sociale si Facebook, Twitter, etj.”

Për shembull, nga 65 transaksione të deklaruar nga subjektet

zgjedhore nën këtë zë, vetëm 44 prej tyre përfshijnë pagesa të drejtpërdrejta ndaj kompanive të rrjeteve sociale / platformave, të tilla si Facebook, Instagram, Google, YouTube, etj. Këto transaksione zënë një vlerë totale prej 3,763,453.00 ALL ose e thënë ndryshe, vetëm 14.25% të shpenzimeve nën këtë zë.

Pjesa tjetër e transaksioneve i referohet pagesave të kryera të kompani ose individë lokalë, duke ofruar shumë pak qartësi për natyrën e shërbimit të marrë dhe kategorizimit të saktë të shpenzimit.

Nëse analizojmë transaksionet e subjektit kryesor deklarues nën këtë zë, Partisë Socialiste, shikojmë se vetëm 1,509,558.00 ALL ose 7.19% e vlerës së deklaruar për “Media Sociale” ka shkuar si pagesë e drejtpërdrejtë ndaj Facebook / Meta. Pjesa tjetër e shpenzimeve lidhet me pagesa ndaj kompanive të marketingut dhe sondazheve, ato të printimit, ose ofrimit të reklamave në natyrë (billboards).

Tabela 11: Transaksionet e deklaruar nga Partia Socialiste për zërin e shpenzimeve “Media Sociale”

Shitësi/ furnitori	Vlera në ALL
I. K.	150,000.00
Facebook	308,811.00
Facebook	349,700.00
Facebook	509,530.00

Facebook	341,517.00
Httpool shpk	606,180.00
Httpool shpk	1,211,160.00
Httpool shpk	1,213,440.00
BNI	9,216,000.00
Dixhi Print AL	2,400,000.00
Digital Bee	3,628,800.00
Httpool shpk	1,073,376.00
Totali Partia Socialiste	21,008,514.00

Në mënyrë të ngjashme, dhe Partia Demokratike dhe subjektet e tjera deklaruese nën këtë zë shpenzimesh kanë deklaruar shpenzime ndaj individëve ose personave fizikë lokalë, duke krijuar paqartësi lidhur me aktivitetet e kryera. Vetëm subjekti Partia e Lirisë ka deklaruar 34 fatura / transaksione ndaj platformave digjitale, duke mos përfshirë pagesa të tjera nën këtë zë.

 *Shpenzimet për reklama politike sipas “Ads Library” të Facebook*

Sipas të dhënave të “Facebooks Ads Library” në rrjet sociale Facebook dhe Instragram janë bërë 1,809 reklama politike gjatë fushatës zgjedhore, me një vlerë totale prej 91,361 USD. Reklama janë bërë në favor të postimeve në faqe të entiteteve

të ndryshme politike, përfshirë kandidatëve për kryetar bashkie, subjekteve politike garuese, politikanë, kryetarë partish dhe kandidatë për këshill bashkiak. Një vlerë e barabartë me 57,852 USD ose 63.1% e totalit të reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve vendore të vitit 2023 është shpenzuar për të promovuar kandidatët për kryetar bashkie. Shpenzimet për të promovuar postimet në faqet e subjekteve elektorale kapin një vlerë prej 19,254 USD ose 21% të totalit, të ndjekura nga shpenzimet për të promovuar kryetarët e partive politike, me 9,966 USD ose 11% të totalit. Për promovimin e kandidatëve për këshillat bashkiak është shpenzuar një shumë modeste prej 1,471 USD.

Gjatë fushatës zgjedhore në Facebook dhe Instagram janë bërë reklama politike që kanë promovuar kandidatët ose politikat e 14 subjekteve zgjedhore. Volumi më i lartë i reklamave ka shkruar në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe kandidatëve ose politikanëve të saj, me një vlerë totale 44,395 USD ose 49% të totalit, e ndjekur nga koalicioni Bashkë Fitojmë me 33,254 USD, një shumë e barabartë me 36% të totalit dhe në vend të tretë qëndron Nisma Thurje me 4,030 USD dhe 4% të shpenzimeve totale.

Tabela 12: Shpenzimet për reklama politike sipas “Ads Library” të Facebook

Entiteti	Shuma e shpenzuar (USD)	%
Kandidat për kryetar bashkie	57,852	63%
Kandidat për KB	1,471	2%
Kryetar partie	9,966	11%
Parti politike	19,254	21%
Politikanë të tjerë	2,818	3%
Totali i shpenzuar	91,361	

Nga shuma totale e reklamave në Facebook prej 91,361 USD, 42,813 USD (46.8%) janë paguar nga partitë politike, 2,818 USD nga politikanë që nuk kanë qenë kandidatë në zgjedhje, 1,471 USD nga kandidatë për këshillat bashkiake dhe 34,347 USD (37.6%) nga kandidatët për kryetar bashkie.

Partia Socialiste ka paguar 41,106 USD reklama në Facebook, nga të cilat 18,645 USD kanë qenë për promovimin e kandidatit për kryetar bashkie në Tiranë, Erjon Veliaj, 6,981 USD për kandidatin për kryetare në Durrës, Emirjana Sako, 3,177 USD për kandidatin për kryetar bashkie në Sarandë, Oltion Çaçi, dhe 400 USD për Sotiraq Filon në Korçë. Ndërkohë, koalicioni Bashkë Fitojmë ka paguar vetëm 1,048 USD për promovim e vetë aktivitetet të tij në fushatë. Kandidatët për kryetar bashkie të këtij koalicioni

i kanë mbuluar kryesisht vetë shpenzimet e fushatës, duke shpenzuar 24,171 USD.

Ndërsa kandidatët e PS-së që kanë financuar vetë reklama në Facebook janë vetëm katër. Ata përfshijnë Benet Becin në Shkodër, Ermal Dredhën në Vlorë, Gledian Llatjan në Elbasan dhe Ervin Demon në Berat. Të marrë së bashku të katër këto kandidatë kanë shpenzuar 2,778 USD.

4. Diskutime dhe Rekomandime

Pabarazitë e mëdha mes mundësisë për të mbledhur të ardhura, sidomos lidhur me zërat “Të ardhura të krijuara nga subjekti” dhe “Financime jopublike”, do vijojë t’i japin partive të mëdha dhe atyre në pushtet një favorizim të qartë në zhvillimin e fushatave zgjedhore.

Gjithashtu, luhatjet e mëdha mes deklarimit të shpenzimeve në subjekte të ndryshme për zëra të caktuar ngrenë pikëpyetje lidhur me mosdeklarimin e saktë të tyre. Për shembull, mungesa e deklarimit të shpenzimeve për “Transport” nga subjekte të mëdha dhe të vogla garuese, pavarësisht monitorimit të aktiviteteve të ndryshme elektorale në zona të largëta nga qendra e bashkisë ose e eksponentëve të tjerë qendrorë të subjektit. Detajimet dhe transparenca e mëtejshme në këtë zë janë shumë të rëndësishme për të monitoruar dhe ndaluar përdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatave zgjedhore.

Vlera shumë e vogël e shpenzimeve të deklaruar nën zërin “Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore”, përkatësisht 402,231.52 ALL (përafërsisht 3,620 Euro), sugjeron se 23,646 kandidatët garues për 1,613 karriget e këshillave bashkiakë kanë mbledhur dhe harxhuar mesatarisht vetëm 17 ALL për kandidat ose

shpenzimet elektorale të tyre nuk janë deklaruar nga subjektet.

Shqetësime ngrihen dhe me mosdeklarimin e shpenzimeve nga asnjë nga subjektet nën zërin “Reklamime në natyrë”, në të cilin përfshihen të gjithë billbordet e monitoruar nga vëzhgues të shumtë gjatë zgjedhjeve të fundit, sidomos ato të vendosur nga vetë drejtuesit e subjekteve në rrugët kombëtare.

Detajimi i mëtejshëm i transaksioneve brenda secilit zë dhe subjekt, ngrenë të tjerë flamuj të kuq, pavarësisht mungesës së të dhënave të detajuara nga ana e lexuesve të raporteve financiare. Për shembull, nën zërin “Shpenzime zyre elektorale”, subjekti Partia Socialiste ka deklaruar 74 transaksione ndaj personave juridikë / individë, me vlerë totale 1,918,876.00 ALL. Nga këto transaksione, mbi 81% janë likujduar me para në dorë / CASH, me vlera që variojnë nga 5,000 ALL në 105,000 ALL. Megjithatë, nën totalin nuk është deklaruar asnjë transaksion për pagesën e Tatimit në Burim, vlerë e cila duhet të paguhet ndaj organeve tatimore nga vetë subjekti përmes bankës.

Nëse kjo vlerë është paguar, por është përfshirë nën zëra të tjerë, atëherë deklarimi ka nevojë për qartësime të mëtejshme, duke pasur parasysh që Partia Socialiste ka deklaruar një transaksion të vetëm lidhur me “Tatimin në Burim” nën zërin e “Shpenzimeve administrative”, nën vlerën totale 284,831.00 ALL. Kjo vlerë është me e vogël se 15% e shumës së pagesave për qira, sidomos kur i njëjti subjekt ka deklaruar dhe transaksione të tjera ndaj individëve nën zëra të tjerë, si dhe është shumë më e vogël se sa vlera e paguar nga një subjekt më i vogël zgjedhor

– për shembull, Partia e Lirisë ka deklaruar 14 transaksione ndaj organeve tatimore me vlerë 2,195,284.00 ALL.

Vetëm subjekti Partia SocialDemokrate ka deklaruar nën zërin “Shpenzime zyre elektorale” transaksione të veçanta ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave. Ky qartësim është i nevojshëm të kryhet nga ana e audituesve të cilët kanë akses në deklarimet e kryera ndaj organeve tatimore për të gjithë subjektet deklaruese.

Siç u diskutua dhe nën seksionin e gjetjeve, validimi i deklarimeve të shpenzimeve lidhur me zërin “Media” është shumë i vështirë bazuar në përkufizimin e dhënë mbi transaksionet që duhet të përfshihen në të, duke e bërë të pamundur ndarjen e transaksioneve të regjistruara ndaj kompanive mediatike në shpenzime për transmetimet audiovizive dhe atyre për median online të këtyre kompanive. Kjo paqartësi e bën të pamundur dhe validimin e gjetjeve të ofruara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, të cilët mbledhin të dhëna vetëm për segmentin e transmetimeve audiovizuale.

Nëse marrim për referencë dy nga kompanitë audiovizive të cilat janë raportuar si furnitorë nga disa subjekte, përkatësisht MTSC dhe Focus Media Group, minutazhi i reklamave sipas raporteve të AMA-s nuk përputhet me vlerat e deklaruara të shpenzimeve të subjekteve zgjedhore.

Tabela 13: Minutazhi i reklamave i monitoruar nga AMA dhe vlerat e shpenzimeve të deklaruara nën zërin “Media” për dy nga kompanitë kryesore audiovizive

Subjekti	ReportTV (MTSC)		News24 (Focus Media Group)	
	Minutazhi sipas AMA	Shpenzimi i deklaruar nga subjekti	Minutazhi sipas AMA	Shpenzimi i deklaruar nga subjekti
Bashkë Fitojmë	-		37.72	
Partia Socialiste	82.55	6,765,368.00	-	
Partia Republikane Shqiptare	-	234,747.00	35.22	410,808.00
Partia Drejtësi, Integritet dhe Unitet	-	500,000.00	31.23	742,000.00
Partia Agrare Ambientaliste	-		5.40	221,260.00
Partia Demokratike	-		-	2,120,000.00
Totali	82.55	7,500,115.00	109.57	3,494,068.00

Mospërputhjet e mësipërme mund të vijnë për një sërë arsyesh, si për shembull: a) nëndeklarimi i shpenzimeve nga ana e subjekteve (rasti i Bashkë Fitojmë) mund të vijë si pasojë e deklarimeve të kandidatëve individualë; b) shpenzimet deklarohen më të larta se minutazhi i reklamave televizive sepse mund të jenë paguar

reklama në mediat online ose kohë tjetër televizive e padëklaruar “reklamë”, e tillë si transmetime live ose reportazhe speciale.

Këto mundësi ritheksojnë dhe një herë detajimin e mëtejshëm të deklarimit financiar, rregullimin për vendosjen e deklarates (disclaimer) në transmetimet të cilat janë të paguara nga subjekti, rregullimi i hapësirës së “transmetimeve live”, si dhe përlllogaritja e të gjithë minutazhit të paguar nga vetë subjektet nën kufizimet kohore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, për të mos tejkaluar 90 minutëshin gjatë fushatës elektorale.

Gjithashtu, nëse të dhënat financiare i krahasojmë me të dhënat e përfituara nga monitorimi i AMA-s, nga lista e furnitorëve mungojnë shumë kompani të tjera audiovizive që kanë transmetuar reklama, sidomos ato lokale, mes të cilave pavarësisht monitorimit të pjesshëm janë regjistruar më shumë se 2,000 minuta reklama për subjektet zgjedhore.

Shqetësues mbetet fakti që asnjë nga subjektet nuk ka deklaruar shpenzime ndaj kompanive të mediave online (digital native), çka rithekson dhe një herë rëndësinë e ngritjes së një sistemi monitorimi dhe raportimi të veçantë të shpenzimeve që lidhen me këtë kategori.

Një problematikë tjetër e identifikuar në seksionin e gjetjeve lidhet me shpenzimet e deklaruara nga subjektet zgjedhore nën zërin “Media Sociale”, ku vetëm një pjesë e vogël e transaksioneve të subjekteve (14.25%) lidheshin me pagesa të drejtpërdrejta ndaj Facebook / Meta. Pjesa tjetër e transaksioneve i referohet pagesave të kryera të kompani ose individë lokalë, duke ofruar

shumë pak qartësi për natyrën e shërbimit të marrë dhe kategorizimit të saktë të shpenzimit.

Duke qenë se kjo problematikë sjell pamundësinë për të monitoruar shpenzimet e subjekteve krahasuar me të dhënat e ofruara nga instrumente të ndryshëm, si Facebook Ads Library, është e rëndësishme që audituesit, por dhe subjektet në raportet e tyre të ardhshme, të tregohen të kujdesshëm në kategorizimin e këtyre shpenzimeve, duke diferencuar prej tyre shpenzime që lidhen me konsulencë, kryerjen e sondazheve, printimeve ose ofrimit të reklamave në natyrë (billboards). Audituesit ligjorë duhet të dalin me gjetje sa më të detajuara në kuadrin e evidentimit të problematikave të raportimit.

Llojet e ndryshme të shpenzimeve të fushatës duhet të kategorizohen qartë, si dhe të jepen përkufizime sa më të sakta se çfarë përfshihet nën secilin zë për të cilat subjektet zgjedhore duhet të raportojnë. Duhet rishikuar pjesët në aktet nënligjore përkatëse (udhëzuesit) për të ofruar udhëzime dhe përkufizime sa më shteruese të llojit të shpenzimit që duhet të përfshihet nën secilën kategori, si dhe rëndësinë e raportimit të secilit transaksion.

Bazuar në problematikën e identifikuar rekomandohet që subjektet zgjedhore (kryefinancierët e partive politike) duhet të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse lidhur me procedurat e raportimit, mënyrën se si duhet të regjistrohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për qëllime të fushatës zgjedhore dhe të shmangin çdo lloj paqartësie lidhur me kategorizimin e

shpenzimeve. Të gjitha palët duhet të ndërgjegjësohen lidhur me detyrimet e tyre për raportimin e financave të fushatës. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar trajnimit të kandidatëve në zgjedhje në mënyrë që të raportojnë saktë te partia politike për të cilën garojnë. Kjo lehtëson edhe pajtueshmërinë me ligjin të subjektit zgjedhor (partisë politike), i cili mban përgjegjësinë për raportimin financiar të kandidatëve, përveç se kur vërtetohet që nuk ka pasur mundësi, ose me të gjitha përpjekjet e bëra, nuk ka arritur të parandalojë apo korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati.

Aneksi I: Deklarimet e kryera gjatë fushatës për zgjedhjet e 14 majit 2023 për secilin zë të ardhurash dhe shpenzimesh sipas subjektit zgjedhor

Kategoria	Zëri / Nënkatëgoria	Partia Demokracia Sociale	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	Partia Republikane Shqiptare	Nisma Thurje	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet
Të ardhurat	Financime publike	1,123,780.00		3,012,429.00		8,018,647.00	9,753,658.00
Të ardhurat	Financime jopublike		158,000.00		780,393.68		
Të ardhurat	Dhurime në natyrë						
Të ardhurat	Të ardhura të krijuara nga subjekti	6,220.00		1,629,350.00	6,285,636.00	130,000.00	
Të ardhurat	Huatë dhe kreditë						
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore		134,500.00				268,800.00
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore						
Të ardhurat totale		1,130,000.00	292,500.00	4,641,779.00	7,066,029.68	8,148,647.00	10,022,458.00
Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore		134,500.00				266,550.00

Shpenzimet	Transport	986,000.00	88,000.00	286,150.00		2,614,749.00	326,000.00
Shpenzimet	Materiale promocionale	144,000.00	40,000.00	655,800.00	271,680.00	1,042,346.00	636,588.00
Shpenzimet	Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë		30,000.00	1,320,626.00	39,250.00	1,638,533.00	449,150.00
Shpenzimet	Shpenzimet administrative			515,877.00	1,014,099.00		676,420.00
Shpenzimet	Media			1,863,326.00		221,260.00	1,542,000.00
Shpenzimet	Media Sociale				435,243.00	25,500.00	
Shpenzimet	Konsulenca					854,500.00	
Shpenzimet	Shpenzime zyre elektorale						541,576.00
Shpenzimet	Botime						424,200.00
Shpenzimet	Shpenzime indirekte/ dhurimet në natyrë						
Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore						
Shpenzimet	Reklamime në natyrë						
Shpenzimet	Botime/ Publikime						
Detyrime të papaguara	Detyrime të papaguara - Media					1,585,834.00	
Shpenzimet totale		1,130,000.00	292,500.00	4,641,779.00	1,760,272.00	7,982,722.00	4,862,484.00
Balanca					5,305,757.68	165,925.00	5,159,974.00

Kategoria	Zëri / Nënkatëoria	Partia Socialiste	Partia e Gjellbër	Bindja Demokratike	Partia Demokratike	Partia Social Demokratike	Partia e Lirisë	Lëvizja Bashkë
Të ardhurat	Financime publike	42,833,467.00	797,915.00	639,799.00	24,963,584.00	-	5,594,216.00	-
Të ardhurat	Financime jopublike	270,000.00	-	-	-	-	856,400.00	899,373.00
Të ardhurat	Dhurime në natyrë	5,301,000.00	-	-	-	-	401,818.00	105,000.00
Të ardhurat	Të ardhura të krijuara nga subjekti	62,968,160.00	2,085.00	-	12,916,509.00	12,266,269.00	15,484,210.00	-
Të ardhurat	Huatë dhe kreditë	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	10,969,230.00	-	-	-	-	32,444,326.57	-
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	-	-	-	-	332,231.52	-
Të ardhurat totale		1,130,000.00	800,000.00	639,799.00	37,880,093.00	12,266,269.00	65,113,202.09	1,004,373.00
Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	10,844,395.00	-	-	-	-	32,444,326.57	-
Shpenzimet	Transport	2,949,068.00	-	-	-	340,217.00	-	30,260.00
Shpenzimet	Materiale promocionale	7,914,700.00	800,000.00	-	9,439,708.00	1,451,762.00	3,150,546.00	264,056.00

Shpenzimet	Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë	6,520,100.00	-	-	13,725,155.00	-	9,567,110.00	145,750.00
Shpenzimet	Shpenzimet administrative	21,132,403.00	-	-	8,620,230.00	944,002.00	15,889,516.00	46,756.00
Shpenzimet	Media	44,627,966.00	-	-	2,670,000.00	-	-	-
Shpenzimet	Media Sociale	21,008,514.00	-	639,799.00	2,215,000.00	-	981,137.00	200,626.00
Shpenzimet	Konsulenca	-	-	-	-	-	2,270,000.00	-
Shpenzimet	Shpenzime zyre elektorale	1,918,876.00	-	-	1,210,000.00	416,565.00	76,517.00	-
Shpenzimet	Botime	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Shpenzime indirekte/ dhurimet në natyrë	5,301,000.00	-	-	-	-	401,818.00	105,000.00
Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	-	-	-	-	332,231.52	-
Shpenzimet	Reklamime në natyrë	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Botime/ Publikime	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të papaguara	Detyrime të papaguara - Media	-	-	-	-	-	3,582,692.00	-
Shpenzimet totale		22,217,022.00	800,000.00	639,799.00	37,880,093.00	3,152,546.00	68,695,894.09	792,448.00
Balanca		124,835.00	-	-	-	9,113,723.00	(3,582,692.00)	211,925.00

Kategoria	Zëri / Nënkatëgoria	Partia e Levizjes së Legalitetit	Partia Balli Kombëtar	Fryma e Re Demokratike	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	Balli Kombëtar Demokrat	Partia Demokristiane	Lëvizja e Re
Të ardhurat	Financime publike	-	-	1,194,064.00	1,100,256.00	-	-	-
Të ardhurat	Financime jopublike	-	-	-	-	1,400,000.00	35,000.00	-
Të ardhurat	Dhurime në natyrë	-	-	125,000.00	-	-	-	-
Të ardhurat	Të ardhura të krijuara nga subjekti	8,018,647.00	-	388,629.00	1,975,536.00	-	-	-
Të ardhurat	Huatë dhe kreditë	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhurat	Të ardhurat totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	42,000.00	-	-	-	-	28,000.00
Të ardhurat totale		8,018,647.00	42,000.00	1,707,693.00	3,075,792.00	1,400,000.00	35,000.00	28,000.00

Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve për Kryetar sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Transport	1,125,451.00	-	675,984.00	901,000.00	198,400.00	-	-
Shpenzimet	Materiale promocionale	395,888.00	-	596,000.00	600,000.00	33,600.00	-	-
Shpenzimet	Mitingje / tubime dhe aktivitete në fushatë	145,000.00	-	-	-	102,600.00	25,000.00	-
Shpenzimet	Shpenzimet administrative	-	-	-	-	1,065,400.00	1,700.00	-
Shpenzimet	Media	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Media Sociale	360,000.00	-	-	546,792.00	-	-	-
Shpenzimet	Konsulenca	220,000.00	-	-	228,000.00	-	-	-
Shpenzimet	Shpenzime zyre elektorale	261,680.00	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Botime	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Shpenzime indirekte/ dhurimet në natyrë	-	-	125,000.00	-	-	-	-

Shpenzimet	Shpenzimet totale të kandidatëve të listave shumëemërore sipas secilës njësi të qeverisjes vendore	-	42,000.00	-	-	-	-	28,000.00
Shpenzimet	Reklamime në natyrë	22,000.00	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet	Botime/ Publikime	-	-	-	800,000.00	-	-	-
Detyrime të papaguara	Detyrime të papaguara - Media	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet totale		2,530,019.00	42,000.00	1,396,984.00	3,075,792.00	1,400,000.00	26,700.00	28,000.00
Balanca		5,488,628.00	-	310,709.00	8,300.00	-	8,300.00	-

Aneksi II: Shpenzimet e deklaruar nga kandidatët në të gjitha bashkitë e vendit gjatë fushatës zgjedhore të 14 majit 2023

Bashkia	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	Partia e Lirisë	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	Partia Socialiste	Grand Total
Belsh		102,823.00		206,000.00	308,823.00
Berat		934,106.00		539,927.00	1,474,033.00
Bulqizë		192,294.00		0	192,294.00
Cërrik		80,833.00		28,951.00	109,784.00
Delvinë		155,000.00		86,800.00	241,800.00
Devoll		305,866.00		154,800.00	460,666.00
Dibër		399,000.00		0	399,000.00
Dimal		40,000.00		200,000.00	240,000.00
Divjakë		105,173.00		0	105,173.00
Dropull		0		0	0
Durrës		2,192,343.00		75,859.00	2,268,202.00
Elbasan		1,070,550.00		35,894.00	1,106,444.00
Fier		196,157.00		138,910.00	335,067.00

Finiq	134,500.00	121,000.00		0	255,500.00
Fushë Arrëz		320,740.00		0	320,740.00
Gjirokastër		85,180.00		249,920.00	335,100.00
Gramsh		107,440.00		31,800.00	139,240.00
Has		181,623.00			181,623.00
Himarë		0		35,500.00	35,500.00
Kamëz		469,604.00		1,000,000.00	1,469,604.00
Kavajë		1,172,528.00		0	1,172,528.00
Klos		156,715.00		0	156,715.00
Kolonjë		192,000.00		314,250.00	506,250.00
Konispol		172,000.00		0	172,000.00
Korçë		442,615.00		381,000.00	823,615.00
Krujë		542,473.00		0	542,473.00
Krumë				0	0
Kuçovë		215,000.00		433,800.00	648,800.00
Kukës		999,793.00		0	999,793.00
Kurbin		456,994.00		303,674.00	760,668.00
Lezhë		397,294.00		361,000.00	758,294.00

Libohovë		5,000.00		0	5,000.00
Librazhd		158,507.00		125,490.00	283,997.00
Lushnje		1,169,900.00		198,240.00	1,368,140.00
Malësi e Madhe		76,309.00		0	76,309.00
Maliq		0		230,250.00	230,250.00
Mallakastër		84,340.00		154,500.00	238,840.00
Mat		65,581.00		80,000.00	145,581.00
Memaliaj		0		0	0
Mirditë		325,000.00		1,658,900.00	1,983,900.00
Patos		277,067.00		309,200.00	586,267.00
Peqin		455,740.00		70,000.00	525,740.00
Përmet		223,137.89		299,880.00	523,017.89
Përrenjas		232,825.00		120,000.00	352,825.00
Pogradec		188,000.00		0	188,000.00
Poliçan		0		0	0
Pukë		436,263.00		0	436,263.00
Pustec		0		5,000.00	5,000.00
Rrogozhinë		316,000.00		140,000.00	456,000.00

Roskovec		55,515.00		1,046,416.00	1,101,931.00
Sarandë		298,018.00		363,041.00	661,059.00
Selenicë		546,455.00		0	546,455.00
Shijak		198,801.00		427,500.00	626,301.00
Shkodër		745,441.00		250,000.00	995,441.00
Skrapar		10,000.00		0	10,000.00
Tepelenë		0		0	0
Tiranë		12,907,900.68	266,550.00	0	13,174,450.68
Tropojë		334,162.00		0	334,162.00
Vau i Dejës		943,275.00		90,136.00	1,033,411.00
Vlorë		547,945.00		697,757.00	1,245,702.00
Vorë		36,000.00		0	36,000.00
Grand Total	134,500.00	32,444,326.57	266,550.00	10,844,395.00	43,689,771.57

* Kandidatët e subjekteve të tjera kanë deklaruar shpenzime në vlerën 0 All.

RAPORT ALTERNATIV:

ANALIZË E RAPORTEVE FINANCIARE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE MBI FUSHATËN ELEKTORALE **2023**

Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative në Shqipëri - Balkan
Investigative Reporting Network in Albania (BIRN Albania)
Tiranë, 2024

